REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 7441/1 Prot. Tiranë, më 27.11.2024

U DH Ë Z I M

NR. 22, DATË 27.11.2024

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 1.12.2023 "PËR PILOTIMIN E SKEMËS SË MËSUESIT NË DISPOZICION DHE DETYRAVE TË TIJ NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6 të nenit 57, të neneve 26 dhe 60 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të urdhrit nr. 565, datë 05.10.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsmit dhe Sportit, znj. Nina Guga", i ndryshuar,

U DH Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 25, datë 1.12.2023 "Për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe detyrave të tij në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar", bëhen ndryshimet si më poshtë:

   a) Kudo në përmbajtje togfjalëshi "*Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*" zëvendësohet me togfjalëshin "*Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar*".

   b) Në pikën 1 të kreut I, togfjalëshi *"...për vitin shkollor 2023-2024."* bëhet *"...për vitin shkollor 2024-2025."*.

   c) Aneksi 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e udhëzimit, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar,

drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

NINA GUGA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

ANEKSI 2

a) Numri i mësuesve në dispozicion sipas ZVAP-së ku do të emërohen

Nr.	DRAP	ZVAP	Numri i mësuesve në dispozicion
1	Durrës	Dibër	2
2	Durrës	Durrës	6
3	Durrës	Krujë	2
4	Tiranë	Kamëz	6
5	Tiranë	Tiranë	20
6	Tiranë	Vorë	2
7	Fier	Fier	6
8	Fier	Gjirokastër-Libohovë	2
9	Fier	Lushnjë	2
10	Fier	Sarandë-Delvinë-Konispol	2
11	Fier	Vlorë-Himarë	6
12	Korçë	Berat	2
13	Korçë	Elbasan	6
14	Korçë	Korçë-Pustec	2
15	Korçë	Librazhd	2
16	Korçë	Prrenjas	2
17	Lezhë	Has	2
18	Lezhë	Kukës	2
19	Lezhë	Lezhë	2
20	Lezhë	Shkodër	6
		Gjithsej mësues	**82**

b) Institucionet arsimore ku do të pilotohet përforcimi

Nr.	DRAP	ZVAP	Institucioni arsimor	Lloji i IA-së	Numri i nxënësve
1	Tiranë	Tiranë	"Kongresi i Manastirit"	Arsim bazë	1462
2	Tiranë	Tiranë	"Edith Durham"	Arsim bazë	819
3	Tiranë	Tiranë	"Vasil Shanto"	Arsim bazë	1207
4	Tiranë	Tiranë	"Fan S. Noli"	Arsim bazë	1070
5	Tiranë	Tiranë	"Emin Duraku"	Arsim bazë	1286
6	Tiranë	Kamëz	"100 Vjetori"	Arsim bazë	1330
7	Tiranë	Kamëz	"Azem Hajdari"	Arsim bazë	1242

8	Tiranë	Vorë	"Vajdin Lamaj"	Arsim bazë	728
9	Durrës	Krujë	"Adem Gjeli"	Arsim bazë	1597
10	Fier	Sarandë-Konispol-Delvinë	"Adem Sheme"	Arsim bazë	945
11	Fier	Fier	"Andon Xoxa"	Arsim bazë	895
12	Durrës	Durrës	"Qemal Mici"	Arsim bazë	985
13	Korçë	Elbasan	"Luigj Gurakuqi"	Arsim bazë	627
14	Lezhë	Shkodër	"Ismail Qemali"	Arsim bazë	844
15	Durrës	Durrës	"Marie Kaçulini"	Arsim bazë	889
16	Durrës	Dibër	"Selim Alliu"	Arsim bazë	797
17	Fier	Gjirokastër-Libohovë	"Koto Hoxhi"	Arsim bazë	815
18	Fier	Fier	"Naim Frashëri"	Arsim bazë	860
19	Lezhë	Kukës	"Avni Rustemi"	Arsim bazë	808
20	Fier	Vlorë-Himarë	"Ismail Qemali"	Arsim bazë	808
21	Lezhë	Has	"Sejdi Dida"	Arsim bazë	774
22	Lezhë	Shkodër	"Ndre Mjeda"	Arsim bazë	702
23	Fier	Vlorë-Himarë	"Jani Minga"	Arsim bazë	963
24	Fier	Lushnje	"Skënder Libohova"	Arsim bazë	674
25	Korçë	Korçë-Pustec	"Sevasti Qirjazi"	Arsim bazë	675
26	Korçë	Elbasan	"Jorgji Dilo"	Arsim bazë	702
27	Lezhë	Lezhë	"Besëlidhja"	Arsim bazë	720
28	Korçë	Prrenjas	"Qybra Sokoli"	Arsim bazë	604
29	Korçë	Librazhd	"Genc Leka"	Arsim bazë	590
30	Korçë	Berat	"22 Tetori"	Arsim bazë	500